




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.480/2022  
Datë: 14 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 37 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 300-të, të mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së, të ndërmerr të gjitha veprimet për të sistemuar z. Hydajet Hyseni si nëpunës brenda Njesisë.
- II. Z. Dulë Gjocaj, caktohet ushtrues i detyrës së Drejtorit të Njesisë për Inspektim Gjyqësor deri në emërimin e drejtorit të Njesisë për Inspektim Gjyqësor.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 14 dhjetor 2022.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 14 dhjetor 2022, ka shqyrtuar mandatin e Drejtorit të Njesisë për Inspektim Gjyqësor, për shkak se drejtorit aktual i përfundon mandati me datë 17 dhjetor 2022. Po ashtu, ka shqyrtuar edhe shkresën e z. Hyseni, ku ndër të tjera i njëjti ka deklaruar se nuk do rikandidoj për Drejtor të NJIGJ, mirëpo me qëllim të dhënies së kontributit të tij brenda sistemit gjyqësor ka shprehur interesim që të vazhdoj punën brenda Njesisë si nëpunës.

Këshilli, pas shqyrtimit dhe analizimit të kësaj çështje, me qëllim rritjes së efikasitetit brenda Njesisë, ka vendosur që të autorizoj Drejtorin e Përgjithshëm të SKGJK-së, të sistemoj z. Hyseni si nëpunës brenda Njesisë, si dhe ka caktuar ushtruesin e detyrës së Drejtorit për Inspektim Gjyqësor deri në emërimin e drejtorit të Njesisë.

Andaj, nga se u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së;
- Z. Hydajet Hyseni;
- Z. Dulë Gjocaj, u.d. Drejtor i Njesisë për Inspektim Gjyqësor;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Arkivit.

